





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.



Nr: 208, Regj., Nr. 1570/1 Prot.

Tiranë, më 17 / 07 / 2019

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark

Për dijëni: Debitorit, Shoqëria Albanian Network Food Industry" sh.p.k., me Admio. Seit Mehalla
NIPT: L72622202R
Adresa: Lagjia "Shen Koll" Rr. "Thoma Kaletit" Elbasan

Kreditorit, Shoqëria "Tre Vellezërit" sh.p.k. me Admi. Haxhi Xhevdet Tufa
Adresa: Banues në Lundër, Rr. "Tufa", Ndërtesa Nr.29, Njësia Admi. Fark, Tiranë

Objekti: Pagesë Fatura Tatimore Shitje

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Shoqërisë Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k., me numër NIPT: L62204027C, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit, Nr. 2187 datë 18.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore 254, kërkesën e kreditorit Shoqëria "Tre Vellezërit" sh.p.k., ndaj Subjektit Shoqëria Albanian Network Food Industry" sh.p.k përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administrator Seit Mehalla, me NIPT: L72622202R, në lidhje me Titullin Ekzekutiv, Faturën Tatimore të Shitjes Nr.9, datë 28.05.2018 me nr. serial 58231809 dhe Nr.4, datë 17.08.2018, me nr. serial 65355204.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.1550/1 Prot, datë 17/06/2019, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit.

KONSTATOVA se :

Debitori Subjekti, Shoqëria Albanian Network Food Industry" sh.p.k përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administrator Seit Mehalla ka refuzuar njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Shoqëria Albanian Network Food Industry" sh.p.k përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administrator Seit Mehalla me NIPT: L72622202R në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (b,c) dhe 46 të Ligjit Nr.10031, Datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".


URDHËROJ

Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:

- 1) Debitori, Shoqëria Albanian Network Food Industry” sh.p.k përfaqësuar nga ortaku i vetem dhe administrator Seit Mehalla me NIPT: L72622202R
Adresa: Lagjia “Shen Koll” Rr. “Thoma Kaletit” Elbasan
- 2) Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:
 - a. Adresën e ushtrimit të aktivitetit privat.
 - b. Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence
 - c. Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit
- 3) Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor
- 4) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- 5) Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “SPAHIU” SH.P.K

Përmbarues GJYQËSOR



Egerem SPAHIU

